



Në bazë të Nenit 3 të Vendimit për përcaktimin e lokacioneve për vendosjen e pajisjeve urbane - objekte të lëvizshme, aparate të lëvizshme dhe aparate të tjera në Parkun e qytetit të Shkupit, Parkun Natyror Gazi Baba, QRS Saraj, "Parku i Parajsës" në Lisiçen e Re dhe bregun e lumit Vardar ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 10/22), kryetari i Qytetit të Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE

për ndarjen e lokacioneve për vendosjen e pajisjeve urbane

1. Lënda

1.1 Lëndë e Thirrjes publike është përcaktimi i mënyrës, kushteve dhe procedurës për përcaktimin e lokacioneve për vendosjen e pajisjeve urbane dhe aparateve të tjera të lëvizshme në Parkun Gazi Baba, Parkun e Parajsës, QRS Saraj, bregun e lumit Vardar dhe Parkun e qytetit në Shkup.

1.2 Pajisjet urbane do të vendosen në 32 lokacione në Parkun e qytetit, 4 lokacione në QRS Saraj, 3 lokacione në Parkun Gazi Baba, 3 lokacione në bregun e lumit Vardar, 2 lokacione në Parkun e Parajsës.

1.3 Lokacionet nga nënpika 1.2 janë përcaktuar në paraqitjen grafike që është pjesë përbërëse e Vendimit për përcaktimin e lokacioneve për vendosjen e pajisjeve urbane - objekte të lëvizshme, aparate të lëvizshme dhe aparate të tjera në Parkun e qytetit të Shkupit, Parkun Natyror Gazi Baba, QRS Saraj, Parkun e Parajsës në Lisiçen e Re dhe në bregun e lumit Vardar ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 10/22)

1.4 Nën termin objekte të lëvizshme nënkuptohen objektet që janë me motor me lëvizje të pavarur ose rimorkio që nuk posedon motor për lëvizje, pra automjete të specializuara për shitje në rrugë, me gjatësi deri në 4 metra dhe lartësi deri në 3 metra, në të cilat mund të ofrohen shërbime të konfeksionuara hoteliere që nuk kanë ndikime negative ekologjike mbi mjedisin (lidhje me rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike ose agregat për furnizimin me energji, me zhurmë të ulët, cilësi të lartë dhe të certifikuar se ka emetime të ulëta të gazrave të dëmshëm).

1.5 Sipërfaqja maksimale e lokacionit ku vendosen pajisjet urbane - objekte të lëvizshme, aparate të lëvizshme dhe aparate të tjera të lëvizshme është deri në 16 m², ku përfshihet objekti i lëvizshëm, përkatësisht aparati i lëvizshëm ose pajisje tjetër e lëvizshme, hapësira manipuluese, pajisje urbane në funksion të shfrytëzimit të lokacionit – kosh për mbetje.

1.6 Pajisjet urbane - objekte të lëvizshme, aparate të lëvizshme dhe aparate të tjera të lëvizshme, të vendosura në një lokacion të caktuar, mund të përdoren vetëm për shitjen e akulloreve, pijeve, produkteve konditore, përgatitjen e kokoshkave, leshit të sheqerit, petullave të ëmbla, krepave dhe produkte të ngjashme.

1.7 Objektet e vendosura, aparatet e lëvizshme dhe aparatet nuk duhet të përmbajnë audio sisteme për të lëshuar muzikë.

1.8 Në pajisjet urbane nga nënpika 1.6 e Thirrjes publike, mund të vendosen mbishkrime reklamuese jo më të mëdha se përmasat e pjesës së përparme të objektit në të cilin është vendosur, dhe dimensionin e tyre (lartësia dhe gjerësia) është pjesë përbërëse e dimensionit të përgjithshëm të objektit.

1.9 Në lokacionet e përcaktuara në nënpikën 1.2 të Thirrjes publike mund të vendosen objektet e lëvizshme, aparatet e lëvizshme dhe aparatet e tjera të lëvizshme që kanë dizajn dhe pamje që nuk prish pamjen e mjedisit përreth ku vendosen në vendet e përcaktuara.

1.10 Pajisjet urbane nga nënpika 1.6 e Thirrjes publike nuk mund të përdoren për shitjen e farërave, si dhe të lajthive, bajameve, fistikëve etj.

2. Korniza kohore për shfrytëzimin e lokacioneve

2.1 Lokacionet ku janë vendosur pajisjet urbane - objekte të lëvizshme, aparate të lëvizshme dhe aparate të tjera jepen në përdorim për një periudhë prej 1 viti.

3. Kushtet dhe procedurat

3.1 Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë të gjithë personat juridikë të interesuar për shfrytëzimin e lokacioneve të përcaktuara në nënpikën 1.2 të Thirrjes publike.

3.2 Aplikanti duhet të ketë aktivitet të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3.3 Të bashkëngjitur me kërkesën për shfrytëzimin e lokacionit për vendosjen e objektit të lëvizshëm, Aplikanti është i detyruar të depozitojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- dëshmi për regjistrimin e veprimtarisë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- dëshmi e posedimit të një pajisjeje fiskale/Dëshmi për kërkesë të paraqitur për lëshimin e një aparati fiskal në DTP, jo më e vjetër se 15 ditë,
- shtojca grafike - skicë me përmasa të sakta të objektit të lëvizshëm dhe
- lokacioni i kërkuar dhe pamja e pajisjeve urbane që do të vendosen (foto).

3.4 Personave juridikë të interesuar që plotësojnë kushtet e pikës 3 do t'u miratohet përdorimi i lokacionit për vendosjen e objekteve të lëvizshme, sipas parimit "I pari që vjen - i pari shërbehet" (të regjistruar në ditë, orë, minutë, sekondë);

3.5 Para marrjes së miratimit, personi juridik i përzgjedhur është i detyruar të paguajë taksën komunale në përputhje me rregulloret në fuqi, si dhe të shlyejë detyrimin ndaj NP “Parqe dhe Gjelbërim” - Shkup për pastrimin e sipërfaqeve publike të gjelbra për instalimin e pajisjeve urbane në përputhje me Listën e çmimeve për shërbime për kryerjen e aktiviteteve të jashtëzakonshme të NP “Parqe dhe Gjelbërim” - Shkup.

3.6 Pas marrjes së miratimit për vendosjen e pajisjeve urbane - objekteve mobile, subjekti i përzgjedhur është i detyruar të lidhë kontratë me NP “Higjiena Komunale” - Shkup për transportin dhe deponimin e mbetjeve, si dhe të depozitojë Aktvendim për regjistrimin e objektit të lëvizshëm të lëshuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së miratimit.

3.7 Afati për depozitimin e aplikimeve është 10 ditë nga dita e shpalljes së Thirrjes publike në UEB FAQEN E QYTETIT TË SHKUPIT.

3.8 Aplikimi dhe paraqitja grafike e lokacioneve mund të shkarkohen në ueb-faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

3.9 Lokacionet për vendosjen e pajisjeve urbane do të shënohen me koordinata në portalin zyrtar të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk në ditën e shpalljes së Thirrjes publike.

Numri	Pika	h	y
1	Parku G.Baba 1	7538170.90	4651280.91
2	Parku G.Baba 2	7538332.83	4651553.27
3	Parku G.Baba 3	7538333.33	4651458.55
4	„Parku i Parajsës“ 1	7540726.95	4649297.93
5	„Parku i Parajsës“ 2	7540872.23	4649211.14
6	QRS Saraj 1	7528435.40	4650849.84
7	QRS Saraj 2	7528502.66	4650833.45
8	QRS Saraj 3	7528638.06	4650809.61
9	QRS Saraj 4	7528784.47	4650855.85
10	Kej 1	7534174.81	4652012.62
11	Kej 2	7535302.77	4651854.88
12	Kej 3	7533111.81	4651767.62
13	Park 1	7535435.72	4651117.87
14	Park 2	7535462.53	4651138.98
15	Park 3	7535481.95	4651167.77
16	Park 4	7535497.71	4651191.91
17	Park 5	7535399.05	4651274.11
18	Park 6	7535508.54	4651282.36
19	Park 7	7535438.84	4651324.28
20	Park 8	7535418.48	4651346.09
21	Park 9	7535182.85	4651300.50

22	Park 10	7535234.46	4651380.97
23	Park 11	7535286.49	4651468.84
24	Park 12	7535317.98	4651522.99
25	Park 13	7535275.33	4651584.79
26	Park 14	7535267.58	4651570.56
27	Park 15	7535232.03	4651594.14
28	Park 16	7535347.29	4651737.86
29	Park 17	7535209.43	4651603.59
30	Park 18	7534807.19	4651706.22
31	Park 19	7534841.75	4651885.64
32	Park 20	7534666.97	4651772.80
33	Park 21	7535507.43	4651041.09
34	Park 22	7535311.97	4651527.89
35	Park 23	7535141.03	4651616.22
36	Park 24	7535155.28	4651807.88
37	Park 25	7534966.04	4651923.57
38	Park 26	7534720.30	4651925.15
39	Park 27	7535354.92	4651402.54
40	Park 28	7535620.54	4651247.74
41	Park 29	7535012.62	4651714.01
42	Park 30	7535106.00	4651723.10
43	Park 31	7535142.23	4651794.85
44	Park 32	7535514.59	4651314.47

Koordinatat janë nga Sistemi i Koordinatave Kombëtare të RMV-së

*Aplikanti, mund të aplikojë më së shumti për 3 (tri) lokacione, të cituara sipas prioritetit.

*Aplikanti mund të marrë leje më së shumti për 2 (dy) lokacione.

3.10 Leja mund të revokohet:

- nëse bartësi i lejes nuk siguron aktet e cituara në pikën 3.6 të Thirrjes publike.
- nëse inspektorët kompetentë të Qytetit të Shkupit konstatojnë se bartësi i lejes nuk vjen në rregullisht në lokacionin për të cilin është dhënë leja,
- nëse nuk i largon rregullisht pajisjet urbane në fund të ditës.

3.11 Aplikimi me të gjithë dokumentacionin nga pika 3, nënpika 3 duhet të depozitohet nëpërmjet arkivit të Qytetit të Shkupit, pranë Sektorit për çështje komunale, me shënimin - Thirrje publike për ndarjen e lokacioneve për vendosjen e pajisjeve urbane.

3.12 Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komisionin për zbatimin e Thirrjes Publike (në tekstin e mëtejshëm Komisioni)

3.13 Komisioni është i obliguar t'i shqyrtojë kërkesat e parashtruara dhe t'i propozojë kryetarit të Qytetit të Shkupit listën e aplikantëve, të cilët i plotësojnë kushtet e Thirrjes publike.

3.14 Nëse aplikimet e paraqitura dhe dokumentacioni i depozituar janë të parregullta (të palexueshme) ose të paplota, Komisioni do t'i refuzojë si të paplota dhe nuk do t'i shqyrtojë, gjë për të cilën do të njoftohet aplikanti. Aplikimet e plotësuara me shkrim dore nuk do të shqyrtohen, përkatësisht do të refuzohen.

3.15 Kryetari i Qytetit të Shkupit, në bazë të propozimit të Komisionit nga nënpika 3.13, do të sjellë Aktvendim për përzgjedhjen e personave juridikë të cilëve do t'u caktohen lokacionet për vendosjen e pajisjeve urbane.

3.16 Subjektet e interesuara ose pjesëmarrësit e Thirrjes publike do të njoftohen për rezultatet e procedurës së zhvilluar në një afat prej 10 ditësh pas përfundimit të afatit për depozitimin e aplikimeve.

3.17 “Qyteti i Shkupit mund ta anulojë thirrjen publike nëse:

- nuk ka arritur asnjë aplikim,
- aplikimet që kanë arritur nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 3 të Thirrjes publike,
- nuk është marrë Aktvendim për ndarjen e lokacioneve për vendosjen e pajisjeve urbane, brenda afatit të përcaktuar në nënpikën 3.16 të Thirrjes publike.

*Arkivi i Qytetit të Shkupit gjendet në adresën bul. «Ilinden» nr.82, 1000 Shkup

Kontakt: Sektori për Çështje Komunale

tel: 02/3297-389

QYTETI I SHKUPIT